

## **INTERVIEW TO ARTAN MEÇO<sup>(\*)</sup>**

**D: Cili eshte roli i Institucionit tuaj ne sektorin e mjedisit dhe kryesisht ne sektorin e ujit?**

**R:** Organet e adminstrimit te rezervave ujore, perberja dhe detyrat e tyre, bashkepunimi me institucionet e tjera.

Sipas ligjit “ Per rezervat ujore”, administrimi i burimeve ujore ne Republiken e Shqiperise kryhet nga Keshilli Kombetar i Ujit dhe Sekretariati Teknik ne nivel Kombetar, si dhe nga autoritetet e baseneve ne nivel lokal.

Republika e Shqiperise ndahet ne 6 basene ujembledhese. Keshillit Kombetar i Ujit ka krijuar organet pergjegjese lokale qe jane keshilli i basenit si organ vendimarrës dhe Agjensia e Ujit si organ ekzekutiv. Sekretariati Teknik i Keshillit Kombetar te Ujit ka bashkepunuar dhe bashkepunon me institucione te ndryshme (duke perfshire edhe Ministrine e Mjedisit ) ne fushen e perdorimit te ujit te pijshem, fushen e shkarkimeve te ujrave te ndotura etj. Nje nga objektivat kryesore te Sekretariatit Teknik te Keshillit Kombetar te Ujit ne kuader te realizimit te programit te qeverise (2005-2009 ) eshte zbatimi i Strategjise Kombetare te Ujit. Ky dokument i rendesishem parashtrohet ne menyre teknike te detajuar te gjitha problemet e ujrave dhe te burimeve ujore qe ndodhen ne territorin shqiptar dhe qe kane lidhje me vendet fqinje. Kjo strategji ka ngarkuar dikasteret dhe institucionet qe lidhen me rezervat ujore, te specifikojne ne menyre te harmonizuar interesat dhe programet ne kete fushe. Nje objektiv tjetër është dhe pergatitja e inventarit qendror te rezervave ujore, si nga ana sasore ashtu dhe cilesore (ST ka filluar perpilimin i tij)

**\* Artan Meço**

Ministria E Rregullimit Te Territorit Dhe Turizmit  
Sekretariati Teknik I Keshillit Kombetar Te Ujit